



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:284902

Datë: 22.01.2021

Numri i dokumentit: 01435020

C.nr.1227/2019

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, si kontestimore, në përbërje me gjyqtarin individual Naim Mehulli dhe me bashkëpunëtorin profesional Eron Prekazi, në çështjen juridike të paditësit F.P i punësuar në Shkollën Fillore të Mesme të Ulët “...” Komuna Zveçan, të cilin sipas autorizimit me shkrim e përfaqëson Sh.A avokat nga Mitrovica, kundër të paditurës K..., të cilën sipas autorizimit me shkrim e përfaqëson D.V avokat nga Mitrovica, me objekt kontesti “kompensimi në emër të ushqimit në punë (shujtave ditore)”, pas mbajtjes së seancës kryesore publike me datë 20.01.2021, me datë 22.01.2021, jashtë seancës, gjykata nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET** kërkesëpadia e paditësit F.P i punësuar në Shkollën Fillore të Mesme të Ulët “...” Komuna Zveçan, si e bazuar, dhe;
- II. OBLIGOHET** e paditura K... , që paditësit F.P t’ia paguajë në emër të shujtave për periudhën kohore nga data 18.04.2017 e deri me datën 11.03.2020, apo për 270 ditë pune (për secilën ditë të pranisë në punë shumën nga 2 euro), shumën prej 540 euro (me fjalë: pesëqind e dyzetë euro) në emër të borxhit kryesor, si dhe kamatën ligjore të llogaritur nga eksperti në shumë prej 39.39 euro, të llogaritura nga eksperti financiar nga data e paraqitjes së padisë e deri me datën e nxjerrjes së ekspertizës, kjo në shumë totale prej 579.39 euro, si dhe kamatën ligjore në lartësi prej 8% për borxhin kryesor, nga dita e nxjerrjes së ekspertizës (datë: 06.11.2020), e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e deri në pagesën definitive të detyrimit, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.
- III. OBLIGOHET** e paditura K... , t’ia paguajnë paditësit shpenzimet e procedurës në shumë të përgjithshme prej 494 euro (me fjalë: katërqind e nëntëdhjetë e katër euro), të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësi Faton Preteni, përmes të autorizuarit të tij avokat Sh.A, me datë 05.12.2019 ka ushtruar padi kundër të paditurës K... , të cilën e ka precizuar në seancën e datës 20.01.2021 duke kërkuar kompensimin për ushqim në emër të ditëve të pranisë në punë (për secilin ditë të pranisë në punë nga 2 euro) dhe atë për periudhën 18.04.2017 e deri me datën 11.03.2020,

shumën prej 540 euro si dhe shumën e llogaritur nga eksperti për kamatën ligjore deri në datën e nxjerrjes së ekspertizës, shumën prej 39.39 euro dhe kamatën ligjore prej 8%, kjo pas datës së nxjerrjes së ekspertizës deri në pagesën definitive, duke u bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovës.

Sipas propozimit të autorizuarit të paditësit për caktimin e ekspertit financiar, gjykata me aktvendimin e saj C.nr.1227/2019 i datës 12.10.2020 ka caktuar ekspertin financiar , i cili është obliguar që të konstatoj ditët e pranisë të paditësit në punë për periudhën e datës 18.04.2017 deri me datën 11.03.2020.

Eksperti financiar me datën 06.11.2020 e ka përpiluar ekspertizën financiare, me të cilën ka konstatuar ditët e pranisë të paditësit, në punë për periudhën e datës 18.04.2017 deri me datën 11.03.2020.

Gjykata, me datën 20.01.2021 ka caktuar seancë për shqyrtim kryesor, në të cilën ka prezantuar i autorizuari i paditësit, ndërsa nga përfaqësuesi i të paditurës askush, edhe pse e njëjta është ftuar në mënyrë të rregullt, mirëpo mungesën nuk e ka arsyetuar, prezent ishte edhe eksperti financiar

I autorizuari i paditësit gjatë seancave gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare mbeti pranë padisë dhe kërkesëpadisë, i propozoi gjykatës të nxjerrë ekspertizë financiare. Bëri precizimin e kërkesëpadisë, i propozoi gjykatës që duke u bazuar në provat e administruara, ta aprovoi kërkesëpadinë e precizuar si të bazuar. I kërkoi shpenzimet e procedurës si në precizim të kërkesëpadisë.

Përfaqësuesi i të paditurës në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 20.01.2020, nuk ishte prezent, por në seancën përgatitore të datës 12.10.2020, kontestoi padinë dhe kërkesëpadinë, kundërshtoj propozimin për ekspertizë financiare, nuk ka pasur propozim për administrim të provave të reja, kurse me datën 20.01.2021 në seancën e shqyrtimit kryesor ka munguar, edhe pse është ftuar me rregull dhe mungesën nuk e ka arsyetuar.

Eksperti financiar ... në seancën e shqyrtimit gjyqësor deklaroi se mbetem në tërësi pranë ekspertizës së dhënë më shkrim. Deri tek konstatimi si në ekspertizë, ka ardhur pas një bashkëpunimi me drejtorin e shkollës ku paditësi ka punuar, borxhi kryesor është 540 euro, ndërsa kamata ligjore është llogaritur nga dita e ushtrimit të padisë deri në nxjerrjen e ekspertizës financiare.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, lidhur me çështjen konkrete juridike, referuar nenit 7 dhe 8 të LPK-së, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik nxori dhe administroi këto prova: Kërkesa e paditësit drejtuar të paditurës e datës 28.10.2019, Kontrata e punës e dt.02.09.2019, Ekspertiza Financiare e datës 06.11.2020 i përpiluar nga eksperti financiar ... , Vërtetimi mbi ditët e pranisë në punë, pas shqyrtimit bashkërisht të të gjithave gjykata konstatoi këtë gjendje:

Gjendja faktike e vërtetuar

Nuk është kontestues fakti se paditësi është i punësuar tek e paditura, pasi kjo vërtetohet edhe nga Kontrata e punës e lëshuar nga Sh.F.M.U. "...” në Komunën e Zveçanit me numër të protokollit 1/48/2019 i datës 03.09.2019, në të cilën janë të specifikuar të drejtat dhe detyrimet e paditësit ndaj të paditurës, e cila si provë u administrua në shqyrtimin gjyqësor.

Nga Vërtetimi me numër të protokollit 1/36/2020 i datës 05.10.2020, vërtetohet se paditësi që nga data 18.04.2017 e deri me datën 11.03.2020 ka gjithsejtë 270 ditë efektive të punës.

Paditësi para ngritjes së padisë me datë 28.10.2019 ju ka drejtuar të paditurës me kërkesë për kompensimin për ushqim për ditët e pranisë në punë, nga shkresat të cilat gjinden në lëndë rezulton se e njëjta nuk ka kthyer përgjigje.

Baza ligjore

Në nenin 4 paragrafi 2 të Ligjit të Punës (nr.03/L-212) i cili ligj është në fuqi, parasheh se *“Kontrata Kolektive nuk mund të përmbajë të drejta më pak të favorshme për të punësuarin dhe punëdhënësin se sa të drejtat e përcaktuara me këtë ligj”*. Ndërsa neni 90 i po këtij ligji parasheh se *“1. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet: 1.1. organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe 1.2. organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve; 2. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në: 2.1. nivel të vendit, 2.2. nivel të degës, 2.3. nivel të ndërmarrjes. 3. Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës. 4. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet. 5. Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive. 6. Marrëveshja Kolektive nuk mund të përfshijë dispozita të tilla që kufizojnë të drejtat e të punësuarve që kanë si pasojë kushte më pak të favorshme të punës sesa ato të përcaktuara në këtë ligj”*

Po ashtu në nenin 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në të cilin parashihet *“Te punësuarve iu njihet e drejta për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të ushqimit për një ditë të pranisë në punë është 2 euro, për të punësuarit që kanë marrëdhënie primare të punës në institucione arsimore. Punëdhënësi i cili e ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve përmes restaurantit apo kuzhinës apo ndonjë forme tjetër nuk e ka obligim për të bërë kompensimin”*.

Vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar dhe provave të administruara në këtë çështje juridike kontestimore, gjykata ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditëses duhet të aprovohet në tërësi, rrjedhimisht, referuar nenit 35 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, parashihet ndër të tjera se përgjegjës për realizimin e të drejtave në shujta ditore është punëdhënësi i fundit, e që në këtë rast nga Vërtetimi mbi ditët e prezencës në punë, të cilën gjykata e administroi si provë, vërtetohet se punëdhënësi i paditëses është K... .

Gjykata me rastin e vendosjes lidhur me lartësinë për pagimin e shujtave ditore, mori parasysh Vërtetimin mbi ditët e prezencës në punë, nga i cila rezulton se paditësi nga hyrja në fuqi e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, me datë 18.04.2017 deri me 11.03.2020, paditësi ka qenë në punë për 270 ditë, andaj është shuma 540 euro, përlllogaritja është bërë duke e shumëzuar numrin 270 me 2 euro.

Gjykata shtjellon faktin sa i përket kamatës ligjore se e njëjta prej datës së paraqitjes së padisë e deri me nxjerrjen e ekspertizës është llogaritur nga ana e ekspertit financiar dhe e njëjta është vendosur në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi tek shuma totale e detyrimit. Ndërsa sa i përket lartësisë së kamatës së përcaktuar prej 8% pas datës së nxjerrjes së ekspertizës, i referohet nenit 382 paragrafi 1 dhe 2 të LMD-së, dhe si moment të fillimit të kamatës, gjykata

ka marr datën e nxjerrjes së ekspertizës, gjegjëshit prej datës 06.11.2020 e deri ne pagesën definitive, pasi siç u sqarua edhe më lartë, kamata ligjore prej datës së paraqitjes së padisë e deri te nxjerrja e ekspertizës është llogaritur nga ana e ekspertit dhe është përfshirë tek shuma totale e detyrimit.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës kontestimore, gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore konform nenit 449 dhe 452 të LPK-së. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara, i referohet shpenzimeve të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit, për përfaqësim për dy seanca të mbajtura, në shumën prej 270.00 euro, në emër të përpilimit të padisë 104.00 euro, shumën prej 100 euro në emër të përpilimit të ekspertizes dhe 20.00 euro në emër të taksës për padi.

Prandaj, gjykata, bazuar në arsyet e cekura me lartë, bazuar në nenin 143 paragrafi 1 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
C.nr.1227/2019, me datë 22.01.2020

GJYQTARI,
Naim Meholli

UDHEZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi, lejohet e drejta ne ankese, ne afat prej 7 ditësh, nga dita vijuese pas ditës se pranimit te këtij aktgjykimi, Gjykatës se Apelit ne Prishtine. Ankesa ushtrohet përmes këtij gjykate.